

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/parandalohet-ngjarja-e-rende-ne-rrogozhine-arrestohet-i-riu-qe-kanosi-me-kallashnikov-35-vjecarin/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 12:32:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 12:27:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3b14cd3122b2f8dd0af0405fb6c1451da3f1defbcf703632aff08e49c28b117f
TEKSTI	2cec4c4ae9a210a040cda1e079bee07bbdd5668ee62fd5e0d6781f7aa7a94d1f
PAMJA	ec5296645152b0975af71dd14624cbc8a2f2bfe088b4da1fe4e2a8e875771785

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5130a53fac0ccaad5b8a31b8aca1d2b651d15e22b1a2eae791d18f9589ed9594
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	2b81d04eb2d7a0b950a06cfe4d4e25424c0bc0e9ce056d5f2521565ca26b7d7f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5130a53fac0ccaad5b8a31b8aca1d2b651d15e22b1a2eae791d18f9589ed9594>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçar

by Bota Bota — September 13, 2026 in Aktualitet, Kronikë

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Një konflikt mes disa personave është parandaluar të përshkallëzohet në një ngjarje me pasoja të rënda për jetën në Rrogozhinë, ndërsa policia ka arrestuar një 26-vjeçar dhe ka sekuestruar një armë zjarri tip kallashnikov.

Në kuadër të operacionit policor të koduar "Prevent 2", shërbimet e Komisariatit të Policisë Kavajë, në bashkëpunim me Stacionin e Policisë Rrogozhinë, arrestuan në flagrancë shtetasit A. I., 26 vjeç, banues në Peqin, dhe O. T., 21 vjeç, banues në Peqin.

26-vjeçari A. I. akuzohet për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit" dhe "Kanosja", ndërsa 21-vjeçari O. T. për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

Ngjarja është regjistruar rreth orës 01:00 të datës 13 shtator 2026, kur policia ka marrë informacion se një person po kanoste me armë zjarri, për motive të dobëta, një 35-vjeçar.

Pas marrjes së informacionit, shërbimet e policisë kanë lokalizuar banesën ku ndodheshin dy të dyshuarit dhe kanë ushtruar kontroll në ambientet e saj.

Gjatë kontrollit, policia gjeti dhe sekuestroi një armë zjarri tip kallashnikov dhe municion luftarak, të cilat u morën në cilësinë e provës materiale.

Sipas policisë, A. I. kishte kanosur për vrasje shtetasin A. S., 35 vjeç, banues në Tiranë, i cili po shkonte në banesën e një 36-vjeçareje në Rrogozhinë, ku ndodheshin A. I. dhe O. T.

Ndërkohë, pas veprimeve procedurale dhe konsultimit me Prokurorin, ka nisur procedimi penal në gjendje të lirë për 36-vjeçaren, e cila akuzohet për "Moskallëzimin e krimit". Sipas policisë, ajo nuk ndodhej në banesë në momentin kur ndodhi konflikti mes dy shtetasve.

Arma e zjarrit dhe municionet e sekuestruara do t'i nënshtrohen ekzaminimeve të mëtejshme kriminalistike.

Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për veprime të mëtejshme.

TË FUNDIT

Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçar

SEPTEMBER 13, 2026

"Qepeni gojën"/ Përplasje për shkrimin e bashkisë në Poliçan, qytetarët braktisin takimin e Ramës

SEPTEMBER 13, 2026

DETAJE nga tritoli në Shkodër/ Autori u maskua si korrier picash, objektiv vëllai i mësuesit ?

SEPTEMBER 13, 2026

Shqipëria, me kostot më të larta të prodhimit bujqësor në rajon

SEPTEMBER 13, 2026

Vila luksoze në Palasë/ Preventivët në kompjuterët e "Atelier 4" nxorën zbuluar Ballukun

SEPTEMBER 13, 2026

"Sot marrin 280% më shumë se administrata"/ Rama reagon sërish për pagat e gjyqtarëve: Është gati 2 mijë euro më e lartë se ajo e Presidentit

SEPTEMBER 13, 2026

Pas arrestimit të Veliajt, futet "në krizë" kompania e vëllait. Fitimet e "Gogel" ulen me 60%

SEPTEMBER 13, 2026

"IA mund të bëhet e rrezikshme nëse nuk menaxhohet siç duhet", Obama ngre alarmin: S'duhet të kontrollohet nga duar private

SEPTEMBER 13, 2026

"Qeni i rrugës e ka tenderin 280 euro, ne nuk marrim as 170 euro pension", pensionisti: Jemi të persekutuar në Shqipëri

SEPTEMBER 13, 2026

30 gëzhoja në vendngjarje/ Detaje nga ngjarja në Mat, familja sapo ishte kthyer nga Italia

SEPTEMBER 13, 2026

Previous Post

"Qepeni gojën"/ Përplasje për shkrimin e bashkisë në Poliçan, qytetarët braktisin



Bota Bota

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Identifikohet shqiptari i vrarë në Itali/ E lidhën dhe e ekzekutuan në makinë, automjetin më pas e hodhën në lumë

0 SHARES



Zjarr masiv në Fier/ Flakët përpijnë me shpejtësi pyllin e Çërnilës

0 SHARES